

Shqip

Epidemia e koronavirusit i prek të gjithë

Ju lutem shpërndajeni informacionin në vijim me të afërmit dhe miqtë tuaj, sqaroheni, shpërndajeni sa më shumë në rrjete sociale. Është e rëndësishme, sepse ende nuk ka imunitet, nuk ka ilaç, nuk ka vaksinë që vepron kundër virusit.

Trajektorja e përhapjes na tregon që nëse qytetarët nuk sillen si duhet, do të kemi mbi 10 milionë të infektuar dhe mbi 100,000 vdekje!

Këto janë shenjat e infektimit me koronavirus:

Simptomat e para të virusit shfaqen 1-2 javë pas kontaktit me personin e infektuar, por virusi mund t'u ngjitet të tjerëve edhe disa ditë para shfaqjes së simptomave.

Simptomat janë të ngjashme me simptomat e ftohjes: temperaturë, kollitje, dhimbje fyti, rrallëherë edhe rrjedhje e hundëve. Shpesh mund të keni probleme me nuhatjen dhe diarre.

Janë tri rrugë që mund të ndiqen nga virusi:

1. Fëmijët e shëndetshëm dhe të rriturit e moshave të reja e tejkalojnë shumë shpesh virusin pa simptoma. Rreth 20% e të infektuarve i takojnë këtij grupi.
2. Të rriturit e shëndetshëm deri në moshën 60 vjeçare zakonisht e tejkalojnë virusin brenda dy javëve, duke treguar simptomat e zakonshme të virusit.
3. 20% e të infektuarve janë mbi moshën 60 vjeçare dhe kanë sëmundje kronike. Ata mund të sëmuren keq. Një në pesë persona nga ky grup që infektohen, duhet të trajtohen me respirator për shkak të pneumonisë dhe rreziku për jetën është i lartë. Në rastin më të keq, disa miliona njerëz nga kjo grupmoshë mund të preken nga virusi.

Ne mund të bëjmë diçka:

Pasi që nuk ka imunitet, vaksinë e as ilaç kundër koronavirusit, masat e tjera janë shumë të rëndësishme!

Ju lutem respektoni këto katër rregulla:

1. Kur është e mundshme, rrini në shtëpi.
2. Mbani distancën.
3. Mbajeni higjienën personale – p.sh. lani shpesh duart, kur kolliteni ose teshtini, bëjeni këtë në anën e brendshme të bërrylit dhe mos e mbani dorën para gojës.
4. Kujdesuni më së shumti për të moshuarit dhe të sëmurët!

Autori i përmbajtjes: Günther Wöhler, specialist i mjekësisë së përgjithshme, guenther.woehler@t-online.de. Shkruar më 24.03.2020.